

# Raporti i Performancës 2019

## *Bashkia Librazhd*

Raporti i Performancës 2019 është një dokument shoqëruar për raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit për vitin 2019 të bashkisë Librazhd. Ai nuk zëvendëson raportin e zbatimit të buxhetit por synon të flasë përveçse me shifra financiare, edhe të tregojë se cilat kanë qënë objektivat e bashkisë për secilin program buxhetor dhe çfarë është realizuar nga bashkia për të arritur objektivat e vendosura gjatë vitit 2019.

### *Proçesi:*

Bashkia në bazë të ligjit për financat e vetëqeverisjes vendore numër 68, datë 2017 përgatit raportin e zbatimit të buxhetit për vitin që sapo mbylli (2019). Ky raport duhet të shoqërohet nga një raport performance i cili synon të tregojë se cilat kanë qënë objektivat e bashkisë dhe se çfarë është realizuar gjatë një viti për të arritur objektivat e vendosura. Objektivat e bashkisë janë pjesë e planit të performances afatmesme buxhetore edhe ky një dokument shoqëruar i Programit Buxhetor Afatmesëm të bashkisë për periudhën 2020-2022. Gjatë muajve janar – shkurt bashkia përveçse ka konsoliduar të dhënat në lidhje me ekzekutimin e buxhetit, ka vlerësuar se çfarë është bërë për çdo program buxhetor të saj. Të dhënat teknike janë mbledhur nga të gjitha drejtoritë teknike të bashkisë nën koordinimin e ngushtë të zyrës së financës. Ky është raporti i dytë i performances që ka realizuar bashkia juaj. Ndërkohë që mund të quhet si raporti i parë i performancës që në të vërtetë synon të masë arritjen e objektivave të synuar për një vit kalendarik. Viti 2018 u bazua në raportet e përgatitura nga bashkia dhe nuk u mor mirëfilli me matjen e objektivave dhe vlerësimin e realizimit të tyre.

Raporti i zbatimit të buxhetit i shoqëruar nga Raporti i Performancës miratohet nga Këshilli Bashkiak sipas kalendarit të miratuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financës.

### *Çfarë ka bërë ndryshe këtë vit bashkia juaj:*

Me mbështetjen e asistencës teknike të qeverisë zvicerane nga agjencia e saj zbatuese Helvetas, nëpërmjet projektit “Bashki të Forta” dhe me ndihmën e konsulentëve të kompanisë Shapo Consulting, ka punuar ngushtësisht me të gjithë stafin teknik të bashkisë përgjatë gjithë vitit 2019 për të matur shifrat faktike të produkteve që realizonte çdo drejtori teknike apo njësi shpenzuese e bashkisë për vitin 2018; si dhe ka vendosur planet për objektivat dhe synimet në lidhje me to për periudhën 2019; 2020 – 2022 si pjesë e procesit të planifikimit vjetor dhe afatmesëm të buxhetit. Rezultat i këtij bashkëpunimi është prodhimi i Planit të Performancës për tre vitet e ardhshme 2020-2022 si edhe Raporti i Performancës 2019 (dokumentat i gjeni bashkëlidhur).

### *Përse shërben një Raport Performance*

Matja dhe raportimi i performancës së funksioneve që realizon/financon bashkia është një proces i vazhdueshëm nga ana e bashkisë që synon matjen, monitorimin dhe raportimin e rezultateve të arritura dhe efijencës së fondeve të përdorura nga ana e bashkisë.

Raporti i performancës në ndryshim nga raporti i zbatimit të buxhetit vjetor synon të vijë në një gjuhë të kuptueshme për disa aktorë të rëndësishëm të bashkisë (Këshilli Bashkiak; komunitetin vendor; median etj) dhe përqendrohet në atë që kërkojnë dhe vlerësojnë përfituesit direkt të shërbimeve të bashkisë, pra çfarë ka realizuar konkretisht bashkia me financat e saj. Duke realizuar një plan performance dhe raportimi i realizimit të tij viti pas viti, bashkia synon të masë dhe raportojë sasinë dhe cilësinë e shërbimit vazhdimisht (nga njëri vit në tjetrin). Në këtë mënyrë bashkia duke ardhur me një gjuhë që flet me rezultate (tregues performance) nxit besim midis bashkisë dhe qytetarëve, në këtë mënyrë ajo sjell më shumë transparencë dhe tregon përgjegjshmëri nga ana e saj.

Ky komunikim do të mundësojë më tej pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimarrje nga njëra anë dhe një vendimarrje më të mireinformuar nga ana e anëtarëve të Këshillit Bashkiak nga ana tjetër

### *Mesazhet më të rëndësishme të Raportit të Performancës për bashkinë tuaj përgjatë vitit 2019*

Bashkia ka **36 funksione ligjore/shërbime** që duhet ti ofrojë komunitetit. Bashkia ka financuar (*alokuar fonde nga të gjitha burimet e financimit të saj qofshin të vetat apo të marra nga QQ dhe donatorët*) **26 funksione**.

Buxheti i bashkisë financohet rreth 19% nga taksat, tarifatat dhe të ardhura të tjera dytësore të bashkisë përfshirë edhe fondet e pashpenzuara një vit më parë dhe 81% nga qeveria qendrore (*transferta të Ministrisë së Financave apo ministrive të linjës dhe FZHSH*). Burimet e financimit janë ulur përgjatë vitit 2019 kundrejt një vit më parë.

Totali i të ardhurave nga burimet e veta të bashkisë është rritur me 8% ndërkohë që financimi nga qeveria qendrore ka rënë me 24%. Në total të ardhurat financiare të bashkisë në fund të vitit 2019 rezultojnë 26% më të ulta sesa ato në vitin 2018. Kjo kryesisht për shkak të rënies së transfertave qeveritare në drejtim të bashkisë. Krahasuar me planin 2019 bashkia ka një realizim 91%, ose 9% më pak se parashikimi.

Shpenzimet buxhetore në total arritën mbi 1,2 miliardë lekë me një rritje prej 40% kundrejt vitit 2018, por me një mosrealizim më të lartë se mosrealizimi i planit të të ardhurave prej 19%. Pësia e investimeve në buxhet ka rënë nga 33% në vitin 2018 në 26% në vitin 2019, por krahasuar me planin e vitit ato janë rreth 22% më të ulta.

Shërbimi më i financuar është ai i Kujdesit Social për familjet dhe fëmijët i cili është rreth 41% e totalit të buxhetit të bashkisë, pasuar për nga rëndësia (pësia) në buxhetin e bashkisë nga ai i mbështetjes së administratës dhe arsimit bazë dhe parashkollor.

*Është për tu cilësuar se bashkia në vazhdimësi ka arritur balancën buxhetore ku raporti shpenzime dhe të ardhura është rreth 98%, duke treguar se shpenzimet janë ekzekutuar tërësisht brenda nivelit të të ardhurave të bashkisë.*

### *Treguesit e performancës përgjithësisht vijnë me përmirësim përveç:*

- ✓ Eficientësi së funksionimit të administratës së bashkisë. Rënie në trajnimin dhe efikasitetin të punës së saj;
- ✓ Eficientësi buxhetore e ofrimit të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri;
- ✓ Angazhimi i qytetarëve dhe konsultimit me publikun në vendimarrjen e bashkisë;

- ✓ Efiçencës financiare të bashkisë në menaxhimin e rrjetit të kanaleve vaditëse dhe kulluese;
- ✓ Mbështetja dhe zhvillimi i turizmit;
- ✓ Efiçenca buxhetore e ndriçimit të hapësirave publike dhe menaxhimi i shërbimit të ndriçimit të territorit;
- ✓ Rënie të fondeve të shpenzuara për sport e argëtim për banor në territorin e bashkisë;

#### *Përmirësim më i madh i funksioneve / shërbimeve që ofron bashkia parashikohet për:*

- ✓ Eficenca e menaxhimit të fondit pyjor dhe kullosor;
- ✓ Menaxhimi i mbetjeve urbane;
- ✓ Mbulimi i hapësirave me ndricim;
- ✓ Shtimi i shpenzimeve për rritjen e larmisë së jetës kulturore dhe sportive për banorët rezidentë të bashkisë.

#### *Sygerime për të përmirësuar performancën e bashkisë përgjatë vitit 2020 dhe tre viteve buxhetore 2021-2023*

##### *Vërejtje të përgjithshme*

- 1) Të ardhurat e veta të bashkisë, (taksa, tarifa dhe të ardhura detyësore ) zënë 10% të totalit të burimeve të financimit nëse nuk merren parasysh të ardhurat e papërdorura nga viti 2018, një shifër kjo që e bën bashkinë të varuar nga transfertat qendrore për sigurimin e fondeve të nevojshme për ofrimin e shërbimeve qytetarëve. Bashkia duhet të rrisë efiçencën në mbledhjen e të ardhurave të veta si edhe të përqëndrohet në programet buxhetore që synojnë rritjen ekonomike të bashkisë nëpërmjet nxitjes së investimeve dhe hapjes së vendeve të reja të punës.
- 2) Bashkia duhet të mbledhë dhe raportojë më shumë të dhëna teknike që lidhen me matjen e performancës së shërbimit. Të konsolidojë sistemin e planifikimit, matjes dhe raportimit të performancës së të gjitha funksioneve dhe shërbimeve që ofron. Treguesit e performancës së përdorur kanë kufizimet e tyre dhe nuk arrijnë të masin të gjitha aspektet e ecures së shërbimit, por ato japin disa sinjale që kryetari i bashkisë dhe drejtuesit e programeve buxhetore është mirë ti kenë parasysh.
- 3) Kryesisht performancë të përkeqësuar ka efiçenca në ofrimin e shërbimeve, rritjen e kostos për njësi të disa shërbimeve të ofruara. Për rrjedhojë bashkia duhet të fokusohet në rritjen e shërbimeve të ofruara/përmirësim të cilësisë së shërbimit të ndriçimit të hapësirave publike, kanaleve ujitëse/kulluese si edhe veprimtaritë sportive dhe argëtuese.